



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:216332

Datë: 15.03.2023

Numri i dokumentit: 04084059

Rev.nr.86/23

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Fejzullah Rexhepi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: M. S. nga fshati B. e U., Komuna Sh., të cilin e përfaqëson Isak Hoxha avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurës: Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në P. rr. “L. e P.”, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar L. R., sipas autorizimit, për kompensim të dëmit, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.242/19, i datës 05.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.03.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pabazuar revizioni i të paditurës: Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në P. rr. “L. e P.”, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.242/19, i datës 05.08.2022.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega Shtërpcë C.nr.14/15, i datës 13.07.2018, është vendosur: I. Aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpafia e paditësit M. S. nga fshati B. e U. Komuna Sh., ashtu që detyrohet e paditurat Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Pr. rr. “L. e P.”, që paditësit në emër të dëmit material, për shkak të fitimit të munguar, për shkak të humbjes së aftësisë punuese, për periudhën e kaluar nga data 03.12.2014 e deri më 28.05.2018, t’i paguaj shumën prej 5,831.50 €, me kamatë prej 8% në vit, nga dita e paraqitjes së padisë deri më datën 31.05.2018 në shumë prej 1,165.39 €, në shumë të përgjithshme prej 6,996.89 €, në emër të fitimit të munguar, si dhe - për kohën e ardhshme nga data 01.06.2018 në formë të rentës në të holla shumën mujore prej 55.50 €, e cila paditësit do t’i paguhet më datën 1 të çdo muaji

vijues deri në ekzistimin e kushteve ligjore. II. Obligohet e paditura e parë Byroja Kosovare e Sigurimeve, t'i paguaj paditësit shumat e cekura si në pikën I, të këtij dispozitivi si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 2,188 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. III. Obligohet paditësi që të paguaj taksën gjyqësore për padi në shumë prej 60 €, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.242/19, i datës 05.08.2022, është vendosur: I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega Shtërpcë C.nr.14/15, i datës 13.07.2018.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovojë revizionin e të paditurës, ashtu që aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë ti prishë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Me përgjigje në revizion paditësi ka kërkuar që Gjykata Supreme e Kosovës revizionin e të paditurës ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit, më datë 17.04.2015, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqit padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit duke kërkuar shumat e specifikuar me saktësisht si në parashtrësën për precizimin e padisë të datës 14.11.2016 dhe 28.06.2018.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë se paditësit kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin C.nr.14/15, i datës 13.07.2018, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: sipas raportit policisë, aksidenti ka ndodhur më datë 30.08.2010, në të cilin paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, si pasojë e humbjes së kontrollit së automjetit "...", të cilin e drejtonte M.S., ku për shkak të mos përshtatjes së shpejtësisë i njëjti duke lëshuar shiritin e tij të djathtë kalon jashtë rrugës dhe godet në një lis me pjesën e përparme të automjetit.

Për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë sa i përket dëmit material - fitimin e humbur, gjykata e shkallës së parë në cilësinë e provës ka marr për bazë mendimin e grupit të ekspertëve mjekësor Dr.Xh. Sh. specialist i mjekësisë së punës, Dr.F. M. ortoped dhe Dr.C. B. ortoped, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në superekspertizën mjekësore të datës 30.10.2017, kanë konstatuar se: paditësi, si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar lëndime të rënda trupore thyerje e qafës së femurit të majtë. Si pasojë e këtyre lëndimeve paditësi ka zvogëlim të përgjithshëm të

aktivitetit punues dhe atë: për vitin e parë pas ditës së aksidentit 100%, për periudhën pas 12 muajve deri 18 muaj 50% dhe pas 18 muajve 18.5%.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit material - fitimin e humbur, gjykata e shkallës së parë në cilësinë e provës ka marr për bazë mendimin e ekspertit të aktuaristikës A. B., i cili në mendimin e tij profesional të dhënë në ekspertizën e datës 11.07.2016 dhe plotësimin të saj më datë 29.05.2018, ka konstatuar se: lartësia e rentës së arritur për paditësin për periudhën e kaluar prej datës 03.12.2014 kur ka arritur moshën 18 vite e deri më datë 31.05.2018 shumë prej 5,831.50 € që së bashku me kamatën prej 8% në vit prej ditë së ushtrimit të padisë më 16.04.2015 e deri më 31.05.2018 prej 1,165.39 €, në total shuma 6,996.89 € dhe për periudhën e ardhshme prej 01.06.2018 e tutje në shumë mujore prej 55.50 €, e cila e paguar në formë të kapitalizuar arrin vlerën prej 15,923.57 €, nga kjo arsye gjykata e shkallës së parë, e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shumat në emër të rentës së arritur dhe rentës për të ardhmen, ashtu siç janë cekur në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimit të saj, duke marr për bazë edhe faktin se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar zvogëlim të aktivitetit punues në shkallën e sipërpërmendur.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 179 paragrafi 2 lidhur me nenin 173 paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 172 paragrafi 2 të LMD-së. Për kamatën iu ka referuar nenit 382 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.242/19, i datës 05.08.2022, ka vendosur që të refuzojë ankesën e të paditurës, duke e vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Aktgjykimi i atakuar është i qartë dhe i kuptueshëm, dispozitivi i të njëjtit është në harmoni me faktet relevante të dhëna në arsyetim, ndërsa arsyet mbi faktet relevante janë në lidhje logjike me provat e nxjerra.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 të LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara. Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt,

dhe si i tillë i plotëson kushtet siç përcaktohet me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së, për arsye se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes me aktgjykimin, nuk ka tejkaluar kërkesëpadinë e paditësit, por e njëjta ka vendosur brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditësit, të precizuar si në parashtrësën të datës 14.11.2016 dhe 28.06.2018, siç përcaktohet me nenin 2 paragraf 1 të LPK-së.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin-gjegjësisht fitimin e humbur paditësit, gjenë mbështetje në nenin 154, 158 dhe 178 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i dt. 30 Mars 1978 i cili ka hyrë në fuqi më datë 01 Tetor 1978.

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij ”, me nenin 158 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 178, të këtij ligji, përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë ”.

Baza juridike nuk ka qenë kontestuese sipas revizionit, prandaj Gjykata Supreme në këtë pjesë sa i përket zbatimit të dispozitave materialo - juridike është kufizuar, duke qenë se deklarimi për bazën është çështje që i referohet disponibilitetet të kërkesave për të cilën palët mund të disponojnë lirishtë në këtë rast.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë dhe e dytë me rastin e vendosjes, drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, lidhur me pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin në formë të rentës së arritur nga data 03.12.2014 - 28.05.2018, së bashku me kamatën dhe në formë të rentës mujore për periudhën pas datës 01.06.2018, e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore për arsye se me nenin 188 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se: “ Në rast të vdekjes, të lezionimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, kompensimi caktohet, si rregull në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar ”, ndërsa në paragrafin 2 të po këtij neni përcaktohet se: “ Renta në të

holla e gjykuar për efekt të kompensimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara në çoftë se gjykata nuk cakton diçka tjetër”, Në këtë rast gjykata duke iu referuar kërkesës së paditësit ka lejuar që me anë të ekspertizës financiare - të aktuaristikës të bëhet llogaritja e rentës së arritur për pagesë dhe llogaritjes së rentës mujore për periudhën e ardhshme dhe nga kjo ekspertizë gjykata ka konstatuar se fitimi i humbur - renta e arritur për periudhën kohore nga data 03.12.2014 e deri më datën 28.05.2018, është në shumën prej 5,831.50 €, ndërsa kamata është në shumën 1,165.39 €, shuma e tërësishme është 6,996.89 €. Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar rentën edhe për periudhën e ardhshme duke pas parasysh ekspertizën e cila vlerësimin e ka mbështetur në rrethanën objektive për t’ a nxjerrë lartësinë dhe atë në shkallën e zvogëlimit të aktivitetit punues dhe në këtë kuptim eksperti iu ka referuar të ardhurave mesatare të punëtorëve të pakualifikuar në Kosovë. Gjykata Supreme e Kosovës e pranon si të besueshme, profesionale dhe të argumentuar mirë ekspertizën e aktuaristikës dhe vlerëson se gjykata e shkallë së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këtë kategori të dëmit sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertit mjekësor i cili ka konstatuar se paditësi ka shkallë të zvogëlimit të aktivitetit punues 18.5%.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur nga e paditura, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale sa i përket fitimit të humbur - rentës së arritur dhe rentës për të ardhmen, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo nuk do të thotë se në të ardhmen palët me ndryshimin e rrethanave nuk mund të kërkojnë ndryshimin e vendimit sa i përket rentës për të ardhmen dhe në këtë kuptim palët e as gjykata nuk mund të thirren në çështje të gjykuar - res iudicata, por ata në çdo kohë mund të kërkojnë ndryshimin e vendimit për rentën në të ardhmen me kusht që ata kanë për detyrë të vërtetojnë ndryshimin e rrethanave që kanë ekzistuar me rastin e caktimit të mbajtjes financiare.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga paditësi nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.86/23, datë 13.03.2023

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi